

Arben Ilia

Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë

Z. Arben Ilia ka lindur më 22 Shkurt 1965 në qytetin e Beratit. Është diplomuar në degën e Inxhinierisë Mekanike dhe Elektronike në Universitetin e Tiranës “Enver Hoxha” dhe mban titullin Inxhinier.

Karriera e tij fillon në vitin 1989 si Inxhinier Mekanik në Ndërmarrjen e Grumbullimit në Berat, duke vijuar më pas në pozicionin e Përgjegjës të Fabrikës në këtë ndërmarrje. Në vitin 1999, mori detyrën e Përgjegjës të Zyrës së Institutit të Zhvillimit të Maqedonisë Perëndimore duke e mbajtur këtë post për plot 11 vite.

Në Korrik të vitit 2012, Z. Ilia u emërua si Drejtor në Bashkinë e Korçës.

Prej Dhjetorit të vitit 2017, Z. Arben Ilia drejton Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë, detyrë të cilën e mban ende sot.